

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"BJORN 1" shpk**

Ne Tirane, sot me date 10.01.2022, (dymije e njezet e dy), ne personat e meposhtem :

**Shoqëria "BJORN" SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS J71904004F, me adresë Qamil Guranjaku, Pall 14/1, Shk 8, Ap 8, përfaqësuar nga **Administratori Manush SINANAJ**, atësia Shefqet, amësia Naile, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Q. Guranjaku P14/1 Sh8 Ap8; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 03/10/1962, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036020552 dhe nr. personal G21003019M,

**Manush SINANAJ**, atësia Shefqet, amësia Naile, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Q. Guranjaku P14/1 Sh8 Ap8; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 03/10/1962, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036020552 dhe nr. personal G21003019M,

*me cilesine e "Ortakeve Themelues", redaktojne kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklarojme se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", me ndryshimet perkatese, ne ligjin "Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **"BJORN 1" shpk**.*

**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"BJORN 1" shpk**.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria **"BJORN 1" shpk**, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë të siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.


Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka seline ne, Tirane, me adresë **Q. Guranjaku P14/1 Sh8 Ap8**.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda





ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 4**  
**Objekti**

Shoqeria do te ushtroje aktivitet tregtar me objekt.

- 1) Ndertim I Centraleve Fotovoltaik, per prodhimin e energjise elektrike,
- 2) Ndertimi I Hidrocentraleve, per prodhimin e energjise elektrike,
- 3) Prodhimi, transmetimi dhe shtrirja e energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et,
- 4) Shfrytezimin dhe mirembajtjen e objektit gjate operimit,
- 5) Shitja e energjise elektrike te prodhuara nga Centrali Fotovoltaik dhe HEC-et,

**Neni 5**  
**Kohezgjatia**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 leke** dhe eshte i perbere nga **2 kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në dy kuota me vlerë, qe perbejne 100% te kapitalit te shoqerise, qe zotërohet nga Ortaket, i ndare ne dy kuota, si me poshte :

**Manush SINANAJ**, zoteruesi i 1 kuote, qe perben 49 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 49.000 leke.

**Shoqeria "BJORN" shpk**, zoteruese i 1 kuote, qe perben 51 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise, me vlere te pergjitheshme 51.000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.


Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;





d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treteve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### **Neni 9**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të pakten tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### **Neni 10**

##### **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga nje administratore.

Administrator i shoqërisë do të jete **z. Manush SINANAJ**, i cili do të ushtroje funksionet në këte detyre për një periudhë **5 vjetore me të drejtë ripërteritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jete të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 11**

##### **Kompetencat**


Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,





Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### **Neni 12**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 13**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### **Neni 14**

##### **Baza Ligjore**


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 15**

##### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.





**Neni 16**

**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortakët e shoqërisë tregtare, nenshkruajne ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet Z. BJOR Sinanaj, i datelindjes 09.08.1990, mbajtes i kartes se identitetit nr J00809054H, per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

**ORTAKET THEMELUES**

**Manush SINANAJ**

*Manush Sinanaj*  
*[Signature]*

**Shoqëria "BJORN" shpk**  
**Administrator Z. Manush SINANAJ**



*Manush Sinanaj*  
*[Signature]*

*dt. 10/1/2022*